



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA**

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Nr. Prot.: 21920

Datë: 24/10/2019

Këshilli i Drejtues i Universitetit të Prishtinës në bazë të kompetencave të përcaktuara sipas nenit 23 të Statutit, në mbledhjen e mbajtur me datën 30.09.2019, miratoi këtë:

RREGULLORE

për mënyrën financimit të shërbimeve që ofrohen nga Qendrat profesionale në Universitetin e Prishtinës, mënyrën e kompensimit të personelit dhe mënyrën e ndarjes së të hyrave të realizuara

Neni 1

Qëllimi

Me këtë Rregullore përcaktohen mënyrat e financimit të shërbimeve të cilat ofrohen në kuadër të fushëveprimit Qendrave profesionale (në tekstin pasues Qendra) të themeluara me vendim të Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës si dhe kriteret e ndarjes së të hyrave të realizuara nëpërmjet shërbimeve të ofruara.

Neni 2

Aktivitetet të cilat përfshihen në këtë rregullore

1. Aktivitetet të cilat përfshihen me këtë rregullore, janë si vijon:
2. Planifikimi, organizimi dhe realizimi i trajnimeve akademike dhe profesionale të përcaktuara me rregullore përkatëse të Qendrës.
3. Organizimi dhe realizimi i programeve certifikuese ndërdisiplinore me kurse nga fusha përkatëse.
4. Planifikimi, organizimi dhe ofrimi i shërbimeve lidhur me studimet dhe kërkimet shkencore në fushëveprimin e Qendrës.

Neni 3

1. Financimi i aktiviteteve dhe shërbimeve të Qendrës nga ana e institucioneve si Komisioni Evropian, USAID, Banka Botërore, Ambasadat e të ngjashme bazohet në rregullat e brendshme të institucioneve të tilla, prandaj nuk i nënshtrohet dispozitave të kësaj rregullore
2. Përfundimisht, në rastet kur lejohet, në koston totale të paraparë për financimin e aktiviteteve dhe shërbimeve nga institucionet si në paragrafin 1 të këtij neni, qendrat duhet të planifikojnë 10 % të shumës totale për nevoja të Zyrës për Kërkime dhe Projekte të Sponsorizuara (ZKPS) të UP-së.

Neni 4

Mënyra e financimit të shërbimeve të cilat ofrohen nga Qendra

1. Për shërbimet të cilat ju ofrohen studentëve të UP-së, Qendra aplikon tarifa siç parashihet në rregulloret ose vendimet përkatëse të saj. Tarifat e tilla janë të krahasueshme me tarifat të cilat UP aplikon lidhur me programet e akredituara mësimore.
2. Për shërbimet lidhur me trajnimet e stafit të UP-së, të cilat bazuar në rregulloret dhe vendimet e instancave përkatëse të UP-së janë të obligueshme, Qendra nuk aplikon tarifa financiare.
3. Shërbimet për stafin e UP-së (përveç atyre si në paragrafin 2 të këtij neni) dhe shërbimet për palët e treta financohen nga vet palët në bazë të kontratave të veçanta.
4. Kriteret e kontratave që lidhen me palët e treta duhet të bazohen në dispozitat e kësaj rregullore dhe aktet tjera ligjore në fuqi.

Neni 5

Mënyra e kompensimit të personelit që merr pjesë në ofrimin shërbimeve

1. Personeli i Qendrës pjesëmarrës në ofrimin e shërbimeve si në paragrafin 1 dhe 2 të nenit 4, kompensohet në bazë të Rregullores për të ardhurat personale të UP-së.
2. Personeli i Qendrës pjesëmarrës në ofrimin e shërbimeve si në paragrafin 3 të nenit 4, kompensohet nga të hyrat e krijuara nëpërmjet financimit të palëve të treta.
3. Personeli i jashtëm, pjesëmarrës në shërbimet e ofruara nga Qendra, kompensohet në bazë të kontratës së veçantë.
4. Kontratat me personelin e jashtëm, lidhur me pagesat nga fondi i UP-së, nënshkruhen nga Rektori i UP-së.

5. Kontratat me personelin e jashtëm, lidhur me pagesat të cilat nuk realizohen nga fondi i UP-së por nga ndonjë institucion të cilin financuesi i projekteve/shërbimeve e ka kontraktuar për këtë qëllim, hartohen dhe realizohen në marrëveshje me financuesin e projekteve/shërbimeve.

Neni 6

Mënyra e ndarjes së të hyrave të realizuara nga shërbimet që ofron Qendra

1. Të hyrat e krijuaranga shërbimet të financuara si në paragrafin 1 dhe 2 të nenit 4, derdhen në buxhetin e UP-së dhe për mënyrën e shpërndarjes së tyre vendos Këshilli Drejtues i UP-së.
2. Të hyrat e krijuara nga shërbimet të financuara si në paragrafin 3 të nenit 4 ndahen si vijon:
 - 2.1. 10% e të hyrave të krijuara do të shkojnë për ZKPS-në.
 - 2.2. 25% e të hyrave të krijuara do të shfrytëzohen për zhvillimin e Qendrës;
 - 2.3. 65 % e të hyrave të krijuara do ti ndahen personelit pjesëmarrës në ofrimin e shërbimeve të caktuara, varësisht nga roli i tyre gjatë kryerjes së shërbimeve.
3. Të hyrat mujore për personelin pjesëmarrës në ofrimin e shërbimeve të caktuara nuk mund të tejkalojnë 2/3 të pagës bazë të tyre.
4. Të hyrat e mbetura pas shpërndarjes si në paragrafin 2 të këtij neni, shkojnë në buxhetin e UP-së përkatësisht të Qendrës në proporcion si është përshkruar në pikën e parë të paragrafit 2 të këtij neni.

Neni 7


Të hyrat tjera

Çdo e hyrë tjetër financiare për Qendrënqë nuk është paraparë me këtë rregullore do të rregullohet me vendim të veçantë të Këshillit Drejtues të UP-së.

Neni 8

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Këshilli Drejtues i UP-së.



Këshilli Drejtues i UP-së

Mr. Sc. Laura Kryeziu - Selimi, kryesuese